

## GRIPI NË SHQIPËRI PËR SEZONIN 2017-2018 JAVA 51 (18 - 24 DHJETOR)

### PËRMBLEDHJE

Në këtë vëllim:

Përmbledhje	1
Prirja e IRS dhe IRP	2
Frekuenca e hasjes	2
Nr total i mostrave	3
SRRA dhe ILI	4
Shpërndarja moshore	5
STRRA	6
STRRA moshore	7
IRA-pragu	9
Kurba epidemike	11
Info nga TESSY	16

#### Informacion kyç:

- Situata ne EURO-TESSY
- Përbërja e vaksinës
- STRRA
- Vaksinimi ndaj Gripit

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se trendi i infeksioneve respiratore paraqet i qëndrueshëm në javën 51/2017. **Krahas virozave të tjera respiratore, në vend është evidentuar qarkullimi i virusit B të gripit i cili gjithashtu mbizotëron edhe në vendet e rajonit dhe të kontinentit europian.**

#### Kontinenti Europian

Në javën 51/2017 intensiteti i aktivitetit të gripit në kontinentin Europian është në ritje. 28 nga 33 vende kanë raportuar intensitet te ulët, 5 vende kanë raportuar intensitet mesatar (IFranca, Holanda, Spanja, Zvicra dhe Turqia).

Në total 32% e mostrave të marra këtë javë janë konfirmuar me viruset e gripit.

Që nga java 40/2017, 59% e mostrave janë me virusin e tipit B dhe 41% e tyre me virusin e tipit A.

Nga nëntipizimi i viruseve të tipit A, 59% e tyre janë të nëntipit A (H1N1)pdm09.

Të dhënat nga 19 shtete ose rajone që raportojnë në projektin EuroMOMO treguan se vdekshmëria nga të gjitha shkaqet ishte në nivele të ulëta dhe të pritshme për këtë kohë të vitit.


Përbërja e vaksinës së gripit për hemisferin verior për sezonin 2017 - 2018 është:

-A/Michigan/45/2015 (H1N1) pdm09-like virus;

-A/Hong Kong/4801/2014 (H3N2) -like virus;


-B/Brisbane/60/2008-like virus.

**1. PRIRJA E INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP) NË JAVËT 35 – 51 TË VITIT 2016 DHE TË VITIT 2017 (NUMRI I RASTEVE).**




Në javën e 51 të vitit 2017 vërehet një trend në rritje i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme por ky numër është 41% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku trendi kishte kaluar pragun epidemik.

**2. FREKUENCA E HASJES SË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME DHE TË POSHTËME” SIPAS RRETHEVE NË JAVËN 50 DHE 51 TË VITIT 2017. INCIDENCA (RASTE/10 000)**



Vërehet rritje e numrit të rasteve të IRA ne disa rrethe te vendit

### 3. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE TË ARDHURA SIPAS JAVËVE DHE REZULTATI LABORATORIK



Prej javës së 1-rë të muajit Tetor 2017 deri më datën 29 Dhjetor 2017 kanë ardhur në ISHP dhe janë testuar 167 mostra nga persona të dyshuar për grip.


Para pranimit në laborator kryhet rregullisht monitorimi i cilësisë së mostrës sipas protokolleve standarte. Të gjitha mostrat e ardhura janë testuar me metodën molekulare të Real-Time RT PCR.


Shumica e mostrave kanë rezultuar negative për viruset e gripit përveç një mostre ku është izoluar virusi B i gripit.

54 kampione të ardhura nga Tirana, Elbasani, Vlora Korça dhe Pogradeci të cilat kanë rezultuar negative për virusin e gripit janë analizuar sipas algoritmit me panelin respirator për 21 viruse. Më poshtë vëmë re se ato kanë rezultuar pozitive për viruse të ndryshëm respiratorë:

Rhinovirus -	4 kampione
Human CoV 229 -	7 kampione
Enterovirus -	3 kampione
Human Adenovirus -	2 kampione
Human RSV -	3 kampione
Human Bocavirus -	1 kampion

**4. NUMRI I MOSTRAVE SRRA DHE ILI TË ARDHURA SIPAS JAVËVE DHE REZULTATI LABORATORIK**




**5. SHPËRNDARJA E NUMRIT TOTAL TË RASTEVE SIPAS GRUP-MOSHËS**

Vërehet që 75 (45%) e mostrave i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç

---


## 6. SËMUNDJE E TEPËR E RËNDË RESPIRATORE AKUTE (STRRA)




Rasti klasifikohet si SRRA (Sëmundje e rëndë respiratore akute sipas përkufizimit të OBSH dhe si STRRA (Sëmundje tepër e rëndë respiratore akute) sipas klasifikimit tonë për të gjitha rastet që kanë nevojë për shtrim në repartet e terapisë intensive dhe kanë nevojë për oksigjenim.

25 (32%) prej 79 pacientëve SRRA kanë paraqitur komplikacione (STRRA)

## 7. SHPËRNDARJA E RASTEVE STRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES SË MOSTRËS




## 8. SHPËRNDARJA E MOSTRAVE STRRA SIPAS GRUPMOSHËS



Vërehet që 14 (56%) e mostrave STRRA i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç


---

**9. SHPERNDARJA E MOSTRAVE SRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES DHE REZULTATIT LABORATORIK**

Numri më i madh i mostrave ka ardhur nga Qendra Shëndetësore Nr. 2, ndjekur nga Qendra Shëndetësore Nr. 4, Spitali Rajonal Elbasan dhe Vlorë.




**10. KRAHASIMI I AKTIVITETIT TË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP)” SIPAS SEZONEVE (JAVËT 40 – 20) DHE PRAGU EPIDEMIK. RASTE/100 0000**





Në javën 51/2017 aktiviteti i IRA paraqet:

- prirje e qëndrueshme
- aktivitet gjeografik të përhapur
- intensitet të ulët
- impakt i ulët

**11. KURBA EPIDEMIKE DHE INFEKSIONET RESPIRATORE SIPAS JAVËVE (IRA RASTE/100 000)**



**12. INTENSITETI I GRIPIT DHE VIRUSET QË QARKULLOJNË NË RAJONIN EUROPIAN NË JAVËN 51.** <http://flunewseurope.org/>



**Departamenti i Epidemiologjisë dhe  
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

Adresa:  
Rr. "A. Moisiu" Nr. 80  
Tiranë

Tel: + 355 42 374 756  
Fax: + 355 42 370 058  
[www.ishp.gov.al](http://www.ishp.gov.al)

---